



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 30 shtator 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim për Caktimin e Datave të Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për  
Parashtrime nga Palët**

**me një Shtojcë Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte***

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së të akuzuarit**

Zhan-Lui Zhilisen

**Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e  
Dëshmitarëve**

Shefit të Zyrës për Mbrojtjen dhe  
Mbështetjen e Dëshmitarëve

**Mbrojtësit të viktimave**

Sajmon Loz

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) lëshon këtë vendim për caktimin e datave të konferencave përgatitore për gjykim dhe për parashtrime nga palët.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 28 janar 2022, Prokurori i Specializuar (ZPS) dorëzoi dosjen e vet paraprake<sup>1</sup> dhe më 29 korrik 2022, sipas autorizimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,<sup>2</sup> ZPS-ja dorëzoi listën e ndryshuar të dëshmitarëve (Lista e Dëshmitarëve të ZPS-së) dhe listën e ndryshuar të provave materiale (Lista e Provave Materiale të ZPS-së).<sup>3</sup>
2. Më 5 shtator 2022, Mbrojtja dorëzoi dosjen e saj paraprake dhe listën paraprake të dëshmitarëve (Lista e Dëshmitarëve të Mundshëm të Mbrojtjes).<sup>4</sup>
3. Më 15 dhjetor 2021, 11 gusht 2022 dhe 19 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi tri vendime ku u pranuan gjithsej tetë viktimat që të marrin pjesë në proces, përkatësisht viktimat 01/04, 02/04, 03/04, 04/04, 05/04, 06/04, 07/04 dhe 08/04.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00135/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Dosjes Paraprake, me Listat e Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, 28 janar 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 8 shkurt 2022, F00139/A01.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00234, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2) dhe Kërkesat në lidhje me Të*, 20 korrik 2022, konfidencial, para. 31, 46(a), (b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 gusht 2022, F00234/RED.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00243, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listave të Ndryshuara të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, 29 korrik 2022, publik, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat e Redaktuara Konfidenciale 3-4. Versionet e redaktuara konfidenciale u dorëzuan po atë ditë, F00243/A03, F00243/A04.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04, F00265, Mbrojtja, *Dosja Paraprake e Mbrojtjes* (Dosja Paraprake e Mbrojtjes), konfidenciale, me një shtojcë konfidenciale.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-04, F00123, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 15 dhjetor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00123/RED; F00249, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 11 gusht 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00249/RED; F00279, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 19 shtator 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00279/RED.

4. Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjykues.<sup>6</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Trupi Gjykues mbështetet në nenet 21, 23 dhe 40(2) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 116-119 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

## III. DISKUTIM

6. Në pajtim me nenet 21, 23 dhe 40(2) dhe (6) të Ligjit dhe rregullat 116(1), (3), (4) dhe 117 të Rregullores, Trupi Gjykues mund të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përgatitjen dhe zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të gjyqimit. Ndër të tjera, këto masa përfshijnë: miratimin e procedurave, modaliteteve dhe udhëzimeve për zhvillimin e procesit gjyqësor; caktimin e afateve për palët dhe pjesëmarrësit për dorëzimin e mocioneve para fillimit të gjyqimit; verifikimin e përmbushjes prej palëve të detyrimeve për nxjerrjen e materialit; dhe sigurimin e masave mbrojtëse përkatëse për dëshmitarët dhe viktimat pjesëmarrëse në proces.

7. Gjithashtu, Trupi Gjykues vlerëson se, në pajtim me nenin 39 të Ligjit dhe rregullat 95 dhe 98 të Rregullores, është, para së gjithash, detyrë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të përgatisë çështjen për gjykim, ndër të tjera, përmes caktimit të gjuhës së punës së procesit; përcaktimit të kornizës ligjore lidhur me kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces dhe pranimin e tyre si viktimat

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-04, F00284, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kalimin e Dosjes Gjyqësore Trupit Gjykues I*, 21 shtator 2022, publik, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

pjesëmarrëse; përcaktimit të sistemit dhe afateve për nxjerrjen e provave dhe redaktimin e materialit; autorizimit të masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat; dhe, në përgjithësi, miratimit të çfarëdo procedure tjetër për të siguruar që palët dhe dosja e çështjes gjyqësore të jenë gati për fillimin e gjykimit. Për këto arsye, përveç nëse vendos ndryshe *proprio motu* ose me kërkesë të palëve apo mbrojtësit të viktimave, Trupi Gjykses nuk synon të bëjë modifikime ose të vendosë nga e para në lidhje me asnjë aspekt për të cilin ndërkohë është marrë vendim nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Rrjedhimisht, vendimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake vijojnë të mbeten në fuqi edhe për Trupin Gjykses.

8. Në pajtim me rregullat 116-119 të Rregullores dhe për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme që konferencat përgatitore për gjykimin të mbahen **të martën, 18 tetor 2022, nga ora 09:00 deri në orën 12:30, të mërkurën, 19 tetor 2022, nga ora 09:30 deri në orën 16:00, të enjten, 20 tetor 2022, nga ora 09:30 deri në orën 17:30 dhe të premten, 21 tetor 2022, nga ora 09:30 deri në orën 15:00, si ditë rezervë.** Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se, ndonëse në Rregullore parashikohen konferenca përgatitore të ndryshme dhe të njëpasnjëshme (rregulla 117: Konferencë Përgatitore për Gjykimin, rregulla 118: Konferenca Përgatitore për Prokurorin e Specializuar dhe rregulla 119: Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen), neni 40(2) i Ligjit i jep Trupit Gjykses kompetencë diskrecionale për të organizuar proces të drejtë dhe të shpejtë në mënyrën që e gjykon të arsyeshme. Trupi Gjykses është i mendimit se, në rrethanat aktuale, grupimi i konferencave të ndryshme përgatitore është mënyra më e përshtatshme dhe më efikase për të vijuar më tej, pasi e lejon që të mbledhë njëkohësisht të gjitha parashtrimet që i duhen për nxjerrjen e udhëzimeve në lidhje me zhvillimin e procesit gjyqësor. Në qoftë se është e nevojshme, Trupi Gjykses mund të vendosë të mbajë

konferenca të mëtejshme për ecurinë e çështjes, ose me kërkesë të palëve apo të mbrojtësit të viktimave, ose *proprio motu*.<sup>7</sup>

9. Për të lehtësuar përgatitjen e konferencave dhe për të siguruar zhvillimin efikas të tyre, Trupi Gjykes kërkon që ZPS-ja, Mbrojtja, mbrojtësi i viktimave dhe Zyra Administrative/Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) të bëjnë parashtrime për pikat e rendit të ditës të përcaktuara më poshtë dhe në shtojcën e këtij vendimi.

A. HETIMET DHE NXJERRJA E PROVAVE

- a. Konfirmim nga ZPS-ja se i ka përfunduar hetimet dhe nxjerrjen e provave shfajësuese në këtë çështje;
- b. Nëse ZPS-ja ka synim t'i nxjerrë Mbrojtjes prova shfajësuese të tjera sipas rregullës 103 të Rregullores, apo material ose prova të tjera sipas rregullës 102(3) të Rregullores - që nuk janë objekt i kërkesës për të cilën ende nuk është marrë vendim<sup>8</sup> – dhe, nëse po, sa materiale dhe kur; gjithashtu, nëse ZPS-ja synon të kërkojë masa mbrojtëse për këtë material ose prova dhe, nëse po, kur;
- c. Nëse, në këtë fazë, Mbrojtja parashikon të zhvillojë hetime të mëtejshme dhe sa kohë afërsisht do t'i duhet për t'i përfunduar këto hetime;

---

<sup>7</sup> Shih gjithashtu KSC-BC-2020-05, F00123, Trupi Gjykes I, *Vendim për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët (Vendimi në Çështjen Mustafa për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin)*, 20 maj 2021, publik, para. 8, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-04, F00261, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Materiale që janë Objekt i Masave Mbrojtëse sipas Rregullës 81(1)(a)*, 2 shtator 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 5 shtator 2022, F00261/CONF/RED.

- d. Nëse, në këtë fazë, si rezultat i këtyre hetimeve, Mbrojtja parashikon të nxjerrë prova shtesë dhe të ndryshojë dosjen paraprake dhe/ose listën e dëshmitarëve të mundshëm të Mbrojtjes;
- e. Nëse Mbrojtja do të kërkojë së shpejti mbajtjen e një seance të mbyllur *ex parte*, për ta përditësuar Trupin Gjykses në lidhje me çfarëdo çështje që ka të bëjë me përgatitjen e saj për gjykim dhe, nëse po, cilat janë pikat që do të diskutojë; dhe
- f. Parashtrime nga palët mbi miratimin e kornizës ligjore për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontakteve me dëshmitarët, duke marrë parasysh kornizën ligjore të miratuar në çështjen KSC-BC-2020-06.<sup>9</sup>

## B. VIZITA NË VENDIN E KRIMIT

- a. Parashtrime nga palët dhe mbrojtësi i viktimave në lidhje me domosdoshmërinë për të vizituar vendin e krimit për administrimin e duhur të drejtësisë, në pajtim me rregullën 74 të Rregullores, dhe caktimin e kohës për çdo vizitë të tillë; dhe
- b. Nëse palët janë në gjendje të dorëzojnë si prova videomateriale, rikonstruksione 3D, harta dhe/ose fotografi të vendit të krimit.

---

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00854, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi*, 24 qershor 2022, publik; F00939, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimit të Vendimit F00854*, 26 gusht 2022, publik.

## C. ZHVILLIMI I PROCESIT

### 1. Fillimi i Gjykimit dhe deklaratat hyrëse

- a. Parashtrime nga palët dhe mbrojtësi i viktimave lidhur me datën paraprake për fillim e gjykimit;
- b. Nëse i akuzuari kundërshton që ZPS-ja të lexojë një përmbledhje të Aktakuzës së Konfirmuar të Korrigjuar<sup>10</sup> gjatë hapjes së çështjes, në vend të të gjithë Aktakuzës,<sup>11</sup> me qëllim që të rritet efikasiteti i procesit;
- c. Nëse ZPS-ja ka ndërmend të bëjë deklaratë hyrëse në pajtim me rregullën 126(1) të Rregullores dhe, nëse po: (i) sa kohë do t'i duhet; dhe (ii) a do të përdorë materiale vizuale ndihmëse apo materiale të tjera;
- d. Nëse mbrojtësi i viktimave ka ndërmend të bëjë deklaratë hyrëse në pajtim me rregullën 126(3) të Rregullores dhe, nëse po: (i) sa kohë do t'i duhet; dhe (ii) a do të përdorë mjete vizuale ndihmëse apo mjete të tjera;
- e. Nëse, në këtë fazë, Mbrojtja parashikon të bëjë deklaratë hyrëse në pajtim me rregullën 126(2) të Rregullores dhe, nëse po: (i) a do ta bëjë këtë deklaratë menjëherë pas deklaratave hyrëse të ZPS-së dhe mbrojtësit të viktimave, nëse do të ketë, apo pas mbylljes së paraqitjes së provave të ZPS-së dhe para fillimit të paraqitjes së provave të Mbrojtjes; (ii) sa kohë do t'i duhet; dhe (iii) a do të përdorë mjete vizuale ndihmëse apo mjete të tjera; dhe
- f. Nëse, në këtë fazë, Mbrojtja mund të bëjë të ditur nëse i akuzuari dëshiron të bëjë deklaratë pa betim në përputhje me rregullën 142(1) të Rregullores

---

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-04, F00107/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Korrigjuar*, 16 nëntor 2021, publike.

<sup>11</sup> Rregulla 124(2) e Rregullores.

dhe, nëse po, a do ta bëjë së bashku me deklaratën hyrëse të Mbrojtjes apo në një fazë të mëvonshme.

## 2. Informimi i dëshmitarëve para dhënies së dëshmisë

Trupi Gjykses synon që në kohën e duhur të japë udhëzime mbi informimin e dëshmitarëve para dhënies së dëshmisë. Palët, mbrojtësi i viktimave dhe Zyra Administrative/ZMMD mund të bëjnë parashtrime lidhur me këtë pikë, nëse dëshirojnë, duke marrë parasysh praktikën e mëparshme të Trupit Gjykses.<sup>12</sup>

## 3. Dëshmitarët-Viktimat me Status të Dyfishtë

Nëse ZPS-ja dhe mbrojtësi i viktimave kanë shkëmbyer informacion për të identifikuar se cilat viktima pjesëmarrëse janë njëkohësisht edhe dëshmitarë të ZPS-së dhe anasjelltas dhe, nëse jo, a planifikojnë ta bëjnë këtë, ose ndryshe, a kanë vërejtje në lidhje me komunikimin ose nxjerrjen e një informacioni të tillë, përfshirë ZMMD-në.

## 4. Paraqitja e dëshmive (të dëshmitarëve) nga palët dhe pjesëmarrësit

- a. Konfirmim nga ZPS-ja i numrit të dëshmitarëve që synon të thërrasë, konfirmim se lista e dëshmitarëve të ZPS-së<sup>13</sup> dhe lista e provave

---

<sup>12</sup> Shih KSC-BC-2020-05, F00150, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Informimin në Tërësi të Dëshmitarëve*, 9 korrik 2021, publik.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-04, F00243/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Listave të Ndryshuara të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, f. 2-4. Versioni i redaktuar konfidencial mund të gjendet si *Shtojca 3 e Parashtrimit të Listave të Ndryshuara të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, F00243/A03.



- materiale të ZPS-së<sup>14</sup> janë përfundimtare, sa kohë kërkon për marrjen në pyetje të tyre dhe a ka ndërmend të thërrasë dëshmitarë ekspertë;
- b. Nëse ZPS-ja ka ndërmend të kërkojë pranimin e deklaratave apo transkripteve të mëparshme në vend të dëshmive gojore sipas rregullave 153-155 të Rregullores, përveç atyre që ka paraqitur në listën e dëshmitarëve të ZPS-së, sipas cilës dispozite ligjore, në lidhje me cilët dëshmitarë dhe sa prova materiale përfshihen. Ndërsa, në parim, i takon secilës palë të përcaktojë organizimin dhe paraqitjen e provave të veta, Trupi Gjykses rikujton se rregullat 153 dhe 154 janë udhëzues të dobishëm për të përshpejtuar dhe thjeshtësuar procesin dhe inkurajon fuqimisht ZPS-në që të mbështetet sa më shumë në rregullat në fjalë;
- c. Nëse, në këtë fazë, dhe në varësi të rregullës 114(5) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave është në gjendje të informojë nëse ka ndërmend të paraqesë prova, të thërrasë dëshmitarë (ekspertë) dhe/ose viktima pjesëmarrëse që të dëshmojnë, ose të kërkojë që viktimat të shprehin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre kur u preken interesat personale; dhe, nëse po, sa kohë kërkon për marrjen në pyetje të dëshmitarëve/viktimave apo për paraqitjen e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të tyre.<sup>15</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses fton mbrojtësin e viktimave që të mbështetet në rregullat 153 dhe 154 nëse do të thërrasë dëshmitarë. Kjo nuk cenon ndryshimet e mëtejshme që do të komunikohen në kohë të mjaftueshme para mbylljes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja;

---

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-04, F00243/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Listave të Ndryshuara të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial është *Shtojca 4 e Parashtrimit të Listave të Ndryshuara të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, F00243/A04.

<sup>15</sup> *Shih* KSC-BC-2020-05, F00152, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi të Drejtat Procedurale gjatë Gjykimit*, 12 korrik 2021, publik, para. 37.

- d. Nëse, në këtë fazë, Mbrojtja është në gjendje të konfirmojë, në pajtim me rregullën 119 të Rregullores, nëse ka ndërmend të paraqesë prova, nëse lista e dëshmitarëve të mundshëm të Mbrojtjes është përfundimtare,<sup>16</sup> nëse Mbrojtja është në gjendje të tregojë numrin e dëshmitarëve që synon të thërrasë, a ka ndërmend të thërrasë dëshmitarë ekspertë dhe kohën që kërkon për marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Kjo nuk cenon ndryshimet e mëtejshme që do të komunikohen në kohë të mjaftueshme para paraqitjes së provave nga Mbrojtja, nëse ka;
- e. Duke marrë parasysh rregullën 104(3) të Rregullores, nëse Mbrojtja synon të përdorë alibinë si mbrojtje;<sup>17</sup> dhe
- f. Nëse Mbrojtja ka ndërmend të kërkojë pranimin e deklaratave apo transkripteve të dëshmive të mëparshme në vend të dëshmive gojore sipas rregullave 153-155 të Rregullores, dhe, nëse po, sipas cilës dispozite ligjore, në lidhje me cilët dëshmitarë dhe sa prova materiale përfshihen. Trupi Gjykses rikujton udhëzimet e veta të mëparshme lidhur me rregullat 153 dhe 154 të Rregullores dhe inkurajon fuqimisht Mbrojtjen që të mbështetet sa më shumë në rregullat në fjalë.

## **5. Radha e paraqitjes dhe çështje të lidhura me marrjen në pyetje të dëshmitarëve**

- a. Parashtrime nga ZPS-ja në lidhje me radhën në të cilën synon t'i thërrasë dëshmitarët e përfshirë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe

---

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-04, F00265/A01, *Shtojcë e Dosjes Paraprake të Mbrojtjes*, 5 shtator 2022, konfidenciale.

<sup>17</sup> KSC-BC-2020-04, F00228, *Mbrojtja, Parashtrime të Mbrojtjes mbi Alibinë në pajtim me Urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të Datës 14 Prill 2022*, 1 korrik 2022; *Dosja Paraprake e Mbrojtjes*, para. 3.

- modalitetet e dhënies së dëshmisë (drejtpërdrejt ose nëpërmjet videolidhjes);
- b. Nëse, në këtë fazë, dhe në varësi të rregullës 114(5) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave mund të bëjë të ditur se në çfarë radhe synon të thërrasë dëshmitarët (ekspertë), dhe/ose viktimat pjesëmarrëse për të dëshmuar ose shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre, nëse kanë, dhe modalitetet e dhënies së dëshmisë/paraqitjes së pikëpamjeve dhe shqetësimeve të tyre (drejtpërdrejt ose nëpërmjet videolidhjes). Kjo nuk cenon ndryshimet e mëtejshme që do të komunikohen në kohë të mjaftueshme para përfundimit të paraqitjes së provave nga ZPS-ja; dhe
- c. Nëse, në këtë fazë, Mbrojtja mund të bëjë të ditur se në çfarë radhe synon të thërrasë dëshmitarët e përfshirë në listën e dëshmitarëve të mundshëm të Mbrojtjes dhe modalitetet e dhënies së dëshmisë (drejtpërdrejt ose nëpërmjet videolidhjes), pa cenuar ndryshimet e mëtejshme që do të komunikohen në kohë të mjaftueshme para paraqitjes së provave nga Mbrojtja.

## **6. Provat që nuk janë dëshmi gojore**

- a. Nëse ZPS-ja synon të kundërshtojë pranueshmërinë e ndonjë prove që nuk është dëshmi gojore sipas rregullës 104 të Rregullores dhe, nëse po, lloji i kundërshtimeve;

- b. Konfirmim se Mbrojtja synon të kundërshtojë pranueshmërinë e provave që nuk janë dëshmi gojore të nxjerra sipas rregullës 102 të Rregullores<sup>18</sup> dhe llojin e kundërshtimeve;
- c. Nëse mbrojtësi i viktimave synon të kundërshtojë pranueshmërinë e provave që nuk janë dëshmi gojore sipas rregullave 102 dhe 104 të Rregullores dhe, nëse po, llojin e kundërshtimeve; dhe
- d. Parashtrime nga palët dhe mbrojtësi i viktimave, duke marrë parasysh praktikën e mëparshme të Trupit Gjykses,<sup>19</sup> nëse vendimi për pranueshmërinë e provave që nuk janë dëshmi gojore duhet të jepet kur ato të paraqiten si prova materiale gjatë vetë gjykimit, apo të lihen për në aktgjykim, pasi palëve dhe mbrojtësit të viktimave t'u jetë dhënë mundësia për të bërë parashtrime, nëse dëshirojnë, lidhur me pranueshmërinë e provave të tilla.

## 7. Konstatimi Gjyqësor i Fakteve të Shqyrtuara në Procese të tjera

Nëse palët, së bashku ose veç e veç, parashikojnë t'i kërkojnë Trupit Gjykses të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera brenda kuptimit të rregullës 157(2) të Rregullores, dhe, nëse po, kur synojnë ta bëjnë një kërkesë të tillë dhe në lidhje me sa fakte.

10. Krahas pikave të përmendura më lart, Trupi Gjykses e konsideron të përshtatshme mbajtjen e një seance të mbyllur *ex parte*, me ZPS-në, ZMMD-në dhe një

---

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-04, F00251, Mbrojtja, *Njoftim i Kundërshtimeve lidhur me Pranueshmërinë e Provave të Nxjerra sipas Rregullës 102 të Rregullores*, publik, me një shtojcë rreptësisht konfidenciale.

<sup>19</sup> KSC-BC-2020-05, F00169, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Paraqitjen dhe Pranueshmërinë e Provave*, 25 gusht 2021, publik.

përfaqësues të Zyrës Administrative, për të diskutuar disa aspekte në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve. Kjo seancë do të mbahet pasi të kenë përfunduar diskutimet me Mbrojtjen dhe mbrojtësin e viktimave dhe do të kufizohet në pikat e renditura në shtojcën e këtij vendimi, pa cenuar të drejtën e Trupit Gjykses për të bërë çfarëdo pyetje tjetër që e gjykon të përshtatshme.

11. Palët, mbrojtësi i viktimave dhe Zyra Administrative/ZMMD-ja urdhërohen të dorëzojnë parashtrime me shkrim në lidhje me pikat e lartpërmendura, si edhe për pikat e renditura në shtojcën e këtij vendimi, sipas rëndësisë për ta, deri **të hënë 10 tetor 2022, në orën 16:00**. Nëse palët ose mbrojtësi i viktimave dëshirojnë të ngrenë pika të tjera përveç atyre të përmendura nga Trupi Gjykses, ftohen ta bëjnë këtë në parashtrimet e tyre. Gjithashtu, nëse dëshirojnë që Trupi Gjykses të mbajë konferenca të mëtejshme për ecurinë e çështjes përpara fillimit të gjykimit, udhëzohen që ta ngrenë këtë pikë në parashtrimet e tyre, duke përfshirë edhe aspektet që dëshirojnë të diskutojnë dhe kohën e mbajtjes së konferencës (konferencave) për ecurinë e çështjes.

12. Së fundi, Trupi Gjykses rikujton se, në pajtim me nenin 40(6)(a) të Ligjit, Trupi Gjykses mund të ushtrojë të gjitha funksionet ose kompetencat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit, si edhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të gjykimit, siç është mbajtja e konferencave për ecurinë e çështjes dhe modalitetet e pjesëmarrjes të përcaktuara në rregullën 96 të Rregullores.<sup>20</sup> Rrjedhimisht, megjithëse z. Shala dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm fizikisht, në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores, konferenca për ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe praninë e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me praninë e mbrojtësit, ose pjesëmarrjen e tij nëpërmjet videokonferencës.

---

<sup>20</sup> *Shih gjithashtu* Vendimi në çështjen *Mustafa* për caktimin e datave për mbajtjen e konferencave përgatitore për gjykimin, para. 15-16.

Gjithsesi, për këto masa nevojitet dhënia e pëlqimit me shkrim nga i akuzuari, pas këshillimit me mbrojtësin e vet, në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores, dhe në përputhje me praktikën e miratuar gjatë fazës së procedurës paraprake.

#### IV. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **VENDOS** që të mbajë konferencë përgatitore për gjykimin, në seancë publike, në praninë e ZPS-së, Mbrojtjes, mbrojtësit të viktimave dhe Zyrës Administrative/ZMMD-së **të martën, 18 tetor 2022, nga ora 09:00 deri në orën 12:30, të mërkurën, 19 tetor 2022, nga ora 09:30 deri në orën 16:00, të enjten, 20 tetor 2022, nga ora 09:30 deri në orën 17:30 dhe të premten, 21 tetor 2022, nga ora 09:30 deri në orën 15:00, si ditë rezervë;**
- b. **VENDOS** të mbajë konferencë përgatitore për gjykimin, *ex parte* dhe në seancë të mbyllur, në praninë e ZPS-së, ZMMD-së dhe përfaqësuesit të Zyrës Administrative, menjëherë pas përfundimit të seancave të mbajtura në datat e lartpërmendura; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-së, Mbrojtjen, mbrojtësin e viktimave dhe Zyrën Administrative/ZMMD-në, të dorëzojnë parashtime me shkrim sikurse përcaktohet në paragrafin 11 të këtij vendimi deri **të hënë, 10 tetor 2022, në orën 16:00.**

/nëshkrimi/  
**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

/nëshkrimi/  
**Gjykatës Zhilber Biti**

/nëshkrimi/  
**Gjykatës Roland Dekers**

E premte, 30 shtator 2022

Në Hagë, Holandë.